VENDIM
Nr. 845, datë 27.9.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË TË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit e të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka si mision garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje dhe përfshirje sociale, arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror, përkujdesje sociale dhe shanse të barabarta, garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët socialë, garantimin e lirisë së besimit fetar e të barazisë së bashkësive fetare dhe mbështet mirëkuptimin e tolerancën ndërfetare.

III. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e punësimit, arsimit dhe formimit profesional.
2. Zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e emigracionit dhe imigracionit të punës.
3. Zhvillimin e politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë.
4. Zhvillimin e politikave dhe monitorimin e politikave, të legjislacionit e të veprimtarive që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore, si dhe procesin e bashkërendimit të punës për skemat e mbrojtjes shoqërore me vendet e tjera.
5. Zhvillimin e politikave, që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.
6. Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnicitetit dhe minoritetit.
7. Zhvillimin e politikave dhe modeleve për ndihmën dhe shërbimet shoqërore alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike.
8. Hartimin dhe rishikimin e standardeve për shërbime të ndryshme shoqërore dhe inspektimin e tyre për garantimin e një shërbimi cilësor.
9. Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social, në kuadrin e partneritetit, me qëllim harmonizimin e interesave të palëve për minimizimin e konflikteve sociale.
10. Bashkërendimin e punës dhe monitorimin e politikave ndërsektoriale të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale që hartohen dhe zbatohen në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucione të tjera qendrore.
11. Hartimin dhe zbatimin e politikave për mbështetjen e rinisë në të gjitha fushat e veprimtarisë.
12. Garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale.
13. Bashkërendimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare. Kjo ministri garanton asnjanësinë në çështjet e besimit, njeh barazinë e bashkësive fetare dhe respekton pavarësinë e tyre. Punon për garantimin e lirisë së besimit e për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfetare në Shqipëri.

IV. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është përgjegjëse për hartimin e strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale, që përfshijnë fushat e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi.

V. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama